

# EC

MA ND RYSHE

PORTEVE

LAGJIA BAZHDARHANE

1 OBJEKTI I POSTËS  
NË PRIZREN

2 HOTEL  
THERANDA

3 SHTËPIA E MALLËRAVE  
"LIRIJA"

4 BANKOSI (ISH-BANKA  
E PRIZRENIT)

14 OBJEKTI I KEK-UT

12 QENDRA  
SHËNDËTËSORE

5 NDËRTESA E GJYKATËS  
NË PRIZREN

7 HOTEL  
PUTNIK

6 STACIONI I  
AUTOBUSËVE

8 FAMIPI  
PRIZREN

9 FABRIKA E TEKSTILIT  
"PRINTEX"

# ECJE

# NË TRASHËGIMINË

# MODERNE TË PRIZRENIT

SHKURT, 2025

Raporti “Ecje në Trashëgiminë Moderne të Prizrenit” është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore për zhvillim të qëndrueshëm në Prizren”, financuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Prizren.

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

Shkurt, 2025



# MODERNIZMI NË PRIZREN

Ky dokument paraqet një përzgjedhje të objekteve arkitekturore moderniste të ndërtuara në Prizren gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Ai përfshin 14 ndërtesa të ndërtuara midis viteve 1945 dhe 1989, të cilat pasqyrojnë karakteristikat kryesore të arkitekturës moderniste të asaj kohe.

Modernizmi Socialist, si drejtim arkitekturor, u zhvillua në kuadër të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, duke u fokusuar në funksionalitet, linja të pastra dhe përdorim racional të materialeve. Këto objekte përfaqësojnë një periudhë të rëndësishme të zhvillimit urban të Prizrenit dhe u ndërtuan për qëllime të ndryshme, përfshirë administratën, arsimin, shëndetësinë dhe tregtinë.

Në vijim, do të shqyrtojmë më nga afër këto 14 objekte, duke theksuar vlerën e tyre arkitekturore dhe historike në kontekstin e qytetit.

# lista:

1. Objekti i Postës në Prizren
2. Hotel Theranda
3. Shtëpia e mallërave “Lirija”
4. Bankosi (ish-banka e Prizrenit)
5. Ndërtesa e Gjykatës në Prizren
6. Stacioni i Autobusëve - Prizren
7. Hotel Putnik
8. Famipa Prizren
9. Fabrika e tekstilit “Printex”

10. Hotel Vëllazërimi
11. Lagjia Ortakoll
12. Qendra Shëndetësore
13. Fabrika e veshmbathjeve “Komuna”
14. Objekti i KEK-ut
15. Radio “Prizreni”
16. Enti për Inkuadrim
17. Lagjia Bezhdarhane
18. Qendra edukative dhe Sociale “Yllka”
19. Halla e Sporteve

# 01 OBJEKTI I POSTËS NË PRIZREN

Objekti i Postës në Prizren është një ndërtesë e rëndësishme publike e ndërtuar gjatë periudhës moderniste në Kosovë. Ky objekt përfaqëson një stil funksionalist tipik të arkitekturës së asaj kohe, me linja të thjeshta, përdorim të betonit dhe fasadës modulare, të karakterizuar nga dritare të radhitura në mënyrë ritmike dhe elemente të metaleve industriale. Ndërtesa është e ndarë në disa nivele, me hyrjen kryesore të theksuar nga një strukturë me shkallë dhe rampa. Sot, ky objekt vazhdon të shërbejë si qendër postare dhe telekomunikimi, duke ruajtur rëndësinë e tij funksionale në qytetin e Prizrenit. Pavarësisht ndryshimeve dhe shtesave të kohëve të fundit, ndërtesa mbetet një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë urbane të qytetit, duke reflektuar transformimet arkitekturore dhe ekonomike të rajonit.

**Emri: Objekti i Postës në Prizren**

**Arkitekti: (Të dhënat e arkitektit nuk janë të konfirmuara)**

**Viti i ndërtimit: Periudha moderniste (gjatë Jugosllavisë)**

**Vendndodhja: Prizren, qendra historike**



**Emri: Hotel Theranda**  
**Viti i ndërtimit: 1964**  
**(U renovua më 1981 dhe 2012)**  
**Vendndodhja: Prizren, Qendër**



Hotel Theranda për herë të parë punën e filloi në vitin 1964, ndërsa objekti u rinovua tërësisht në vitin 1981 dhe sërish në vitin 2012. I vendosur në qendër të Prizrenit, hoteli kufizohet me disa nga monumentet më të rëndësishme të qytetit, si Kalaja e Prizrenit, Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit dhe Xhamia e Sinan Pashës. Hoteli ofron akomodim në 90 dhoma të ndryshme dhe përfshin tre salla konferencash me kapacitet deri në 300 ulëse, si dhe një sallë të dedikuar për ngjarje të ndryshme sociale dhe kulturore. Me arkitekturën e tij të përshtatur me ambientin historik të qytetit dhe shërbimet e tij bashkëkohore, Hotel Theranda vazhdon të mbetet një nga pikat referuese të turizmit në Prizren, duke pritur vizitorë nga e gjithë bota.

## **02 HOTEL THERANDA**

# 03 SHTËPIA E MALLËRAVE

## “LIRIJA”

Shtëpia e Mallrave "Lirija" është një nga objektet më të rëndësishme tregtare të ndërtuara në Prizren gjatë modernizimit urban të viteve 1960. Ajo u ndërtua në vitin 1968 nga arkitekti Stanko Mandić, duke u shndërruar në një qendër kryesore tregtare. Para ndërtimit të saj, zona kishte objekte tradicionale, të cilat u zëvendësuan me një arkitekturë moderne, por gjithsesi të harmonizuar me ambientin urban të qytetit. xhami dhe metali. Fasada është konceptuar për të ofruar një ndriçim natyral dhe një përvojë të këndshme për blerësit. Hapësirat e brendshme janë të organizuara sipas sektorëve kryesorë, ku përfshihen supermarketi, sektori i tekstit dhe modës, sektori i pajisjeve shtëpiake dhe elektronikës, si dhe sektori i mobiljeve. Pavarësisht ndryshimeve urbanistike, ky objekt vazhdon të mbetet një nga simbolet e jetës tregtare në Prizren.



**Emri: Shtëpia e mallërave “Lirija”**  
**Arkitekti: Stanko Mandic**  
**Viti i ndërtimit: 1968**  
**Vendndodhja: Prizren, afër lumit**  
**Bistrica**



**Emri: Bankosi (Ish-Banka e Prizrenit)**

**Arkitekti: Zoran Kreitmayer**

**Viti i ndërtimit: 1984**

**Vendndodhja: Prizren, qendra e qytetit**

Ish-Banka e Prizrenit, e njohur sot si Bankosi, është një objekt me rëndësi arkitektonike dhe administrative. Me një fasadë të ndërtuar nga betoni dhe xhami, ky objekt kishte një funksion të rëndësishëm si qendër financiare, përpara se të kalonte në administrimin e Komunës së Prizrenit pas vitit 1999. Ndërtesa është një shembull i modernizmit arkitekturor të viteve 1980 dhe një nga pikat orientuese të qytetit, duke përfaqësuar kalimin nga arkitektura tradicionale në zhvillimin bashkëkohor të Prizrenit.



**04 BANKOSI**  
**(ISH-BANKA E PRIZRENIT)**

**Emri: Ndërtesa e Gjykatës në Prizren**  
**Viti i ndërtimit: 1950-1960**  
**Vendndodhja: Prizren, në qendër të qytetit**



Ndërtesa e Gjykatës në Prizren është një shembull i arkitekturës funksionale të periudhës socialiste, e ndërtuar në vitet 1950-1960 për të mbështetur zhvillimin e administratës dhe sistemit gjyqësor. Ajo ka një planimetrinë drejtkëndore me disa kate, duke përdorur materiale të qëndrueshme si tulla dhe beton, që i japin një pamje të thjeshtë e të qëndrueshme. Fasada e saj siguron ndriçim natyral dhe harmonizim me ambientin urban. Ndërtesa ka shërbyer për një gamë shërbimesh administrative dhe gjyqësore, duke përfshirë salla gjyqësore, zyra dhe arkiva. Funkzioni i saj i vazhdueshëm si Gjykata Themelore e Prizrenit e bën atë një qendër të rëndësishme për drejtësinë në qytet, duke kontribuar në administrimin e çështjeve civile, penale dhe administrative. Rëndësia e saj arkitektonike dhe funksionale mbetet e theksuar edhe pas renovimeve të shumta.

# 05 NDËRTESA E GJYKATËS PRIZREN



**Emri: Stacioni i Autobusëve – Prizren**  
**Viti i ndërtimit: Vitet 1970**  
**Vendndodhja: Pjesa lindore e Prizrenit, pranë hyrjes kryesore të qytetit**

# 06 STACIONI I AUTOBUSËVE PRIZREN

Stacioni i Autobusëve në Prizren është një kryesore e transportit publik të qytetit, duke lidhur Prizrenin me qendrat tjera urbane të Kosovës dhe rajonit. I ndërtuar gjatë periudhës socialiste, objekti pasqyron qasjen funksionale të arkitekturës së asaj kohe, me theks te qendrueshmerise, efikasitetit dhe qarkullimit të lirshëm i udhëtarëve. Objekti ka një strukturë të ulët, të ndarë në dy pjesë kryesore: terminalin e pasagjerëve dhe zonën e pritjes së autobusëve. Kulmi i lakuar dhe mbulesat me pllaka të kuqe të mbështetura nga shtylla betoni e bëjnë ndërtesën të dallueshme. Hapësirat e brendshme janë të organizuara në mënyrë funksionale, duke përfshirë sportele për biletat, zona pritjeje dhe hapësira komerciale.



**Emri: Hotel Putnik**  
**Arkitekti i instalacioneve:**  
**Miroslav Simeunovic**  
**Zyra projektuese: PLAN**  
**Viti i ndërtimit: 1983**  
**Vendndodhja: Prizren, "Rruga**  
**Tirana"**

Hotel Putnik ishte një objekt akomodimi i ndërtuar në vitin 1983 në Prizren. Ndodhej në "Rruga Tirana" dhe kishte një sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>. Projekti u realizua nga zyra projektuese "PLAN", ndërsa arkitekti i instalacioneve ishte Miroslav Simeunovic. Ky hotel ishte një pjesë e zhvillimit urban të qytetit, duke ofruar shërbime akomoduese për vizitorët dhe turistët. Megjithatë, ne ditët e sotit, fatkeqsisht ky objekt nuk ekziston më.

## **07 HOTEL PUTNIK**

Objekti FAMIPA Prizren është një ndërtesë industriale, pjesë e kompleksit të fabrikës R.O. "Famipa", e cila shërbente si një nga qendrat kryesore të prodhimit të metaleve dhe plastikës në rajon. Fabrika pati një rol të madh në zhvillimin ekonomik të zonës, duke krijuar vende pune dhe duke ndikuar në industrinë e përpunimit të metaleve. Ndërtesa ishte e organizuar në sektorë funksionalë, ku përfshiheshin halla kryesore e prodhimit, dy magazina për ruajtjen e produkteve, zona administrative dhe garderoba me ambientet ndihmëse për punonjësit. Sot, objekti nuk funksionon si fabrikë dhe disa pjesë të tij janë transformuar në markete, depo ose hotele. Pavarësisht kësaj, produktet e FAMIPA-s ende qarkullojnë në tregjet e koleksionistëve, duke reflektuar historinë e industrisë së Prizrenit.

**Emri: FAMIPA Prizren**  
**Arkitekti: Renda Mimin**  
**Viti i ndërtimit: 1983**

**Vendndodhja: Prizren, Zona industriale**



# 08 FAMIPA PRIZREN



**Emri: Fabrika e Tekstilit  
"Printex"**

**Arkitekti: Kalin-Vehovar  
Nives**

**Viti i ndërtimit: 1974  
Vendndodhja: Prizren,  
Bazhderhane**

Fabrika e Tekstilit "Printex" është një nga objektet më të rëndësishme industriale të ndërtuara gjatë periudhës socialiste në Kosovë. E projektuar nga arkitektja Kalin-Vehovar Nives dhe e ndërtuar në vitin 1974 në zonën e njohur si Bazhderhane, kjo fabrikë luajti një rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe industrial të qytetit. "Printex" u krijua për të përmbushur nevojat e tregut vendas dhe të eksportit, duke u specializuar në prodhimin e tekstileve, përfshirë fije pambuku dhe pëlhura sintetike. Me kalimin e kohës dhe ndryshimet ekonomike, "Printex" filloi të përballej me sfida të mëdha, deri në mbylljen e fabrikës në vitet '90. Sot, ndërtesa e "Printex" mbetet një simbol i historisë industriale të Prizrenit, pavarësisht transformimeve të saj.

# **09 FABRIKA E TEKSTILIT PRINTEX**

# 10 HOTEL VËLLAZËRIMI

Hotel Vëllazërimi është një nga simbolet e arkitekturës moderniste në Prizren, duke pasqyruar zhvillimin urban dhe kulturor të qytetit në fund të shekullit XX. Ky hotel u ndërtua për të akomoduar turistët dhe vizitorët, ndërsa njëkohësisht ka shërbyer si një qendër për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe shoqërore. Dizajni i hotelit është një shembull i arkitekturës moderniste, me linja të pastra, forma të thjeshta dhe përdorim të betonit dhe xhamit në fasadë, duke krijuar një pamje elegante dhe funksionale. Ambientet e brendshme janë të organizuara për rehati dhe praktikitet, me hapësira të ndriçuara natyrisht dhe holl të gjerë.

**Emri: Hotel Vëllazërimi**  
**Viti i ndërtimit: 1970**  
**Vendndodhja: Prizren**



# 11 LAGJIA ORTAKOLL



Lagjja Ortakoll është një nga zonat më të njohura dhe të planifikuara të Prizrenit, e ndërtuar në vitet 1980 për të akomoduar rreth 7,000 banorë. Kjo lagje përmban një kombinim të ndërtesave kolektive dhe shtëpive individuale, të rrethuar me infrastrukturë moderne si parqe, fusha sportive, shkolla dhe qendra shëndetësore. Projektimi i lagjes, i realizuar nga urbanistja Hysnije Hisari, kishte për synim krijimin e një hapësire të organizuar mirë, me ndërtesa pesë deri në tetë kate dhe hapësira të bollshme për jetesë. Një nga projektet kyçe të realizuara këtu ishte ndërtimi i një blloku banimi nga "KOSOVOPROJEKT", projektuar nga inxhinier arkitekt Nikola Kojić dhe Zorka Jovanović-Mesarović.

**Emri: Lagjja Ortakoll**  
**Arkitektja: Hysnije Hisari**  
**Viti i ndërtimit: 1980**  
**Vendndodhja: Veriperëndimi i Prizrenit**





**Emri: Qendra Shëndetësore**  
**Arkitekti: Bezbradica Stevan**  
**Viti i projektimit: -**  
**Vendndodhja: Prizren,**  
**qendra e qytetit**

Qendra Shëndetësore e Prizrenit është një objekt strategjik, i për të siguruar akses të shpejtë dhe të lehtë për të gjitha zonat urbane dhe periferike. Ky kompleks mjekësor është projektuar për të përmbushur nevojat shëndetësore të popullsisë në mënyrë efikase dhe moderne. Objekti është i organizuar në tre blloqe funksionale të ndërlidhura mes vete: Ndërtesa është projektuar për të optimizuar ndriçimin dhe ajrosjen natyrale, duke ofruar kushte të përshtatshme për pacientët dhe stafin mjekësor. Sistemi i integruar i ashensorëve dhe korridoret e gjera ndihmojnë në lëvizjen efikase të pacientëve dhe materialeve mjekësore.

# 12 QENDRA SHËNDETËSORE

# 13 FABRIKA E VESHMBATHJEVE “KOMUNA”



Fabrika e veshmbathjes "Komuna" në Prizren është një nga objektet industriale të rëndësishme të qytetit, e ndërtuar në vitin 1986. Projektimi i saj është realizuar nga arkitektja Peric Leposava, e cila ka kontribuar në krijimin e një strukture funksionale dhe moderne për periudhën në të cilën është ndërtuar. Kjo fabrikë ka pasur një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik dhe industrial të Prizrenit dhe rajonit, duke ofruar mundësi punësimi dhe duke përbushur nevojat e tregut vendas për produkte tekstile.

**Emri: Fabrika e  
Veshmbathjeve "Komuna"**  
**Arkitekti: Peric Leposava**  
**Viti i ndërtimit: 1986**  
**Vendndodhja: Prizren**

**Emri: Fabrika e  
Veshmbathjeve "Komuna"  
Arkitekti: Peric Leposava  
Viti i ndërtimit: 1986  
Vendndodhja: Prizren**

Objekti i KEK-ut në Prizren është një nga ndërtimet që përfaqësojnë zhvillimin industrial dhe infrastrukturor të qytetit në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Ai është ndërtuar gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste dhe ka shërbyer si një qendër kyçe për shpërndarjen dhe menaxhimin e energjisë elektrike në rajon. Arkitektura e tij përfaqëson stilin modernist të kohës, me një dizajn funksional dhe minimalist, ku dominojnë format gjeometrike të thjeshta dhe përdorimi i materialeve si betoni dhe tulla. Edhe pse është një objekt industrial, ai ka ndikuar në transformimin urban të Prizrenit, duke sjellë një element modern në një qytet të njohur për arkitekturën e tij tradicionale osmane.



# 14 OBJEKTI I KEK-UT

# 15 RADIO PRIZRENI

Objekti i Radio Kosovës në Prizren është një ndërtim i realizuar në vitin 1978, i projektuar nga arkitekti Rasim Hoxha. Ky objekt është ndërtuar si një strukturë lineare me një kat, e ngritur mbi nivelin e terrenit për 0,60 metra. Toka rreth objektit është mbushur dhe shtypur për të arritur lartësinë e nevojshme për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e ndërtimit.

Objekti përfshinte një sërë hapësirash funksionale që shërbejnë për aktivitetet e ndryshme të radiostacionit, duke përfshirë studio, regjistrim, sallë të madhe, diskotekë, zyra të administratës dhe një zyrë për përdorime të tjera. Fasada e objektit është mbuluar me Teraplast dhe ngjyra e saj është zgjedhur sipas preferencave të investitorit, ndërsa piedestali është i ndërtuar me gur artificial.



**Emri: Radio Prizren**  
**Arkitekti: Rasim Hoxha**  
**Viti i ndërtimit: 1978**  
**Vendndodhja: Prizren**

**Emri: Enti për Inkuadrim**  
**Arkitekti: Dobrivoje Bojkovic**  
**Viti i ndërtimit: 1969**  
**Vendndodhja: Prizren**



Enti për Inkuadrim - Prizren është një ndërtesë e rëndësishme dhe një shembull i arkitekturës moderne në Prizren, e ndërtuar në vitin 1969. Arkitekti i këtij projekti është Dobrivoje Bojkovic, një emër i njohur në fushën e arkitekturës, i cili ka kontribuar në shumë projekte në ish-Jugosllavi dhe më pas në rajon. Ndërtesa e Entit për Inkuadrim është një shembull i arkitekturës postmoderniste, që reflekton karakteristikat e periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, ku ndodhi një rritje e ndjeshme e zhvillimit urban dhe industrial. Kjo ndërtesë është e njohur për linjat e saj të pastra, përdorimin e materialeve të forta dhe funksionalitetin e lartë.

# 16 ENTI PËR INKUADRIM

Lagjja Bazhdarhane është një shembull i rëndësishëm i planifikimit urbanistik të fundit të viteve '70, duke kombinuar hapësirat rezidenciale me ato të rekreacionit dhe funksioneve publike. Projekti urbanistik përfshiu një plan të detajuar të hapësirave publike, sistemimin e gjelbërimit përmes një projekti të hortikulturës dhe infrastrukturën për aktivitete sociale dhe sportive. Në këtë lagje janë ndërtuar terrene sportive, një kënd lojërash për fëmijë dhe hapësira të dedikuara për komunitetin. Konceptimi arkitektonik dhe urbanistik u drejtua nga arkitekti Pavle Pavlović me asistencën e Višnjic Arsenije. Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit u projektuan nga Žitico Koalezić, me asistencën e Ljubica Stefanović. Për instalimet elektrike dhe sistemin e rrufeshkarkuesit, nuk ka informacione të specifikuar në dokumentacionin ekzistues. Projekti u hartua në Prishtinë në tetor të vitit 1978 dhe përfaqëson një model të avancuar të mendimit urbanistik dhe arkitekturor të kohës, duke reflektuar një qasje të strukturuar ndaj hapësirave të banimit dhe jetës komunitare.

**Emri: Lagjja Bazhdarhane**  
**Arkitekti: Pavle Pavlović (me asistent Višnjic Arsenije)**  
**Viti i projektimit: 1978**  
**Vendndodhja: Prizren**



# 17 LAGJIA BAZHDARHANE

# 18 QENDRA EDUKATIVE DHE SOCIALE “YLLKA”



Qendra e Fëmijëve "Yllka" në Prizren është një objekt arkitektonik i ndërtuar në vitet 1970-1980, i projektuar për fëmijët dhe duke reflektuar parimet e asaj periudhe. Arkitektura e saj është funksionale dhe e thjeshtë, me një strukturë të ulët (një ose dy kate), të shtrirë horizontalisht, dhe e rrethuar me hapësira të gjelbra për lojërat e fëmijëve. Ndërtesa ka dritare të mëdha që lejojnë ndriçim natyral dhe është e dizajnuar për të ofruar kushte të mira për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Vlera arkitektonike e kësaj qendre qëndron në përshtatjen e saj me nevojat psikologjike dhe edukative të fëmijëve. Dizajni i saj përqendrohet në krijimin e një hapësire të hapur dhe të ndriçuar natyralisht, duke ndihmuar në zhvillimin e tyre social dhe arsimor.

**Emri: Qendra Edukative dhe Sociale  
"Yllka"**

**Viti i ndërtimit: 1970-1980**

**Vendndodhja: Prizren**


**Emri: Halla e Sporteve**  
**Arkitektët: Miroslav Cočanović,**  
**Dragan Radulović**  
**Viti i ndërtimit: -**  
**Vendndodhja: Prizren**

Halla e Sporteve në Prizren është një nga investimet më të mëdha në infrastrukturën sportive të qytetit, duke ofruar hapësira moderne për aktivitete sportive dhe ngjarje publike. Objekti është ndërtuar në një terren të sheshtë dhe ka një sipërfaqe prej 8,430.76 m<sup>2</sup>, duke përfshirë hapësira për parkim dhe fusha të hapura sportive. Ndërtimi është organizuar në mënyrë simetrike, me dy nivele hyrjeje: një në nivelin 0.00 për stafin dhe pjesëmarrësit dhe tjetra në nivelin +3.60 për publikun. Projektimi u realizua nga Miroslav Cočanović dhe Dragan Radulović, ndërsa për inxhinierinë mekanike, elektrike dhe ndërtimore ishin angazhuar Žarko Radovanović, Mirko Lazarević, Stojan Gligorijević dhe Srboljub Arsić. Kjo ndërtesë vazhdon të jetë një qendër e rëndësishme për zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve komunitare në Prizren.



# 19 HALLA E SPORTEVE





**P  
R  
I  
Z  
R  
E  
N  
I  
E  
N  
I  
E  
C  
J  
E  
NË  
T  
R  
A  
S  
H  
Ë  
G  
I  
M  
I  
N  
Ë  
M  
O  
D  
E  
R  
N  
E**

NË RRUGËT E PRIZRENIT, MES GURËVE TË KALLDRËMIT DHE FASADAVE TË VJETRA, QËNDROJNË ENDE DËSHMI TË NJË KOHE TJETËR – PERIUdhËS MODERNISTE. NDËRTESA TË NDËRTUARA MES VITEVE 1960 DHE 1990, ME LINJA TË DREJTA DHE FORMA TË GUXIMSHME, DIKUR MISHËRONIN NJË ËNDËRR PËR NJË TË ARDHMË TË NDRITUR DHE DINAMIKE. SOT, DISA PREJ TYRE KANË HUMBUR FUNKSIONIN E TYRE, DISA JANË TRANSFORMUAR, NDËRSA TË TJERA QËNDROJNË SI MONUMENTE TË HESHTURA TË NJË EPOKE QË PËRPIQEMI ENDE TA KUPTOJMË.


NGA SHTËPIA E MALLRAVE "LIRIJA" TE HOTEL "THERANDA", NGA FABRIKAT E DIKURSHME SI "PRINTEX" DHE "FAMIPA" DERI TE QENDRAT PUBLIKE SI STACIONI I AUTOBUSËVE DHE QENDRA SHËNDETËSORE, SECILI PREJ KËTYRE OBJEKTEVE KA MBAJTUR BRENDA TIJ HISTORITË E PUNËTORËVE, BLERËSVE, UDHËTARËVE E BANORËVE TË QYTETIT. ATO NUK ISHIN THJESHT NDËRTESA – ISHIN RITMI I PËRDITSHMËRISË, VENDTAKIME TË JETËS URBANE, PIKA REFERIMI NË KUJTIMET E NJERËZVE.

ME KALIMIN E VITEVE DHE NDRYSHIMET E MËDHA SHOQËRORE E EKONOMIKE, SHUMË PREJ TYRE JANË LËNË PAS DORE OSE JANË TRANSFORMUAR NË MËNYRA QË SHPESH I SHKËPUTIN NGA IDENTITETI I TYRE FILLESTAR. POR NUK JANË ZHDUKUR KREJTI. NË SHIKIMIN E NJË KALIMTARI TË VËMENDSHËM, NË HIJET QË HEDHIN NË DIELLIN E PASDITES, ATO ENDE FLASIN PËR KOHËN KUR MODERNIZMI PËRPIQEJ TË GJENTE RRËNJË NË KËTË QYTET TË LASHTË.

"ECJE NË TRASHËGIMINË MODERNE TË PRIZRENIT" ËSHTË NJË FTESË PËR TË DËGJUAR KËTO HISTORI TË PASHKRUARA, PËR TË NJOHUR DHE KUPTUAR MË MIRË KËTO STRUKTURA QË DIKUR FORMËSUAN NJË PJESË TË JETËS SË QYTETIT. ATO JANË PJESË E KUJTESËS SONË KOLEKTIVE – TË VJETRA, POR ENDE TË GJALLA NË ARKITEKTURË, NË KUJTIME, DHE NDSHTA NË TË ARDHMEN QË DO TË VIJË.

**RRETH NESH**

EC ANGAZHONET PËR QËNDRUESHMËRI EKONOMIKE DHE QEVERISJE DEMOKRATIKE NË NIVEL LOKAL (DHE RAJONAL) PËRMES MOBILIZIMIT TË KOMUNITETIT, MBIKËQYRJES SË VENDIMMARRJES PUBLIKE DHE PARTNERITETIT NË ZBATIM TË PROGRAMEVE DHE POLITIKAVE ZHVILLIMORE.



### 1. OBJEKTI I POSTËS NË PRIZREN

I ndërtuar gjatë periudhës moderniste, ky objekt përfaqëson një arkitekturë funksionaliste me linja të thjeshta dhe fasadë modulare. Ndodhet në qendrën historike të Prizrenit dhe ka shërbyer si qendër postare dhe telekomunikimi. Me hyrje të theksuar, shkallë dhe rampa, ndërtesa ruan rëndësinë e saj funksionale, duke mbetur një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë urbane të qytetit.

### 2. HOTEL "THERANDA"

I hapur fillimisht në vitin 1964, ky hotel është rinovuar në vitet 1981 dhe 2012. I vendosur në qendër të Prizrenit, pranë monumenteve historike si Kalaja e Prizrenit dhe Xhamia e Sinan Pashës, hoteli ofron 90 dhoma dhe disa salla konferencash. Me arkitekturë të përshtatur me ambientin historik, "Theranda" mbetet një pikë referuese e turizmit në qytet.

### 3. SHËTËPIA E MALLRAVE "LIRIJA"

E ndërtuar në vitin 1968 nga arkitekti Stanko Mandić, kjo shtëpi mallrash është një ndër objektet më të rëndësishme tregtare të Prizrenit. Ndodhet pranë lumit Bistrica dhe lagjeve historike Pantelia dhe Potkalaja. Me një arkitekturë moderne dhe një organizim në tri nivele, ky objekt ka qenë një qendër e rëndësishme tregtare dhe vazhdon të jetë pjesë e jetës urbane të qytetit.

### 4. BANKOSI (ISH-BANKA E PRIZRENIT)

Projektuar nga arkitekti Zoran Kreitmayer dhe ndërtuar në vitin 1984, ish-Banka e Prizrenit, sot Bankosi, është një objekt me rëndësi arkitektonike dhe administrative. E vendosur në qendrën e qytetit, ky objekt modernist i viteve '80 me fasadë betoni dhe xhami ishte një qendër financiare para se të kalohej në administrimin komunal pas vitit 1999.

### 5. NDËRTESA E GJYKATËS NË PRIZREN

E ndërtuar në vitet 1950-1960, kjo ndërtesë shërben si qendra gjyqësore e qytetit. Me një arkitekturë funksionale, plani i saj drejtkëndor përfshin disa kate, me një organizim të qartë të hapësirave për administratë dhe sallat gjyqësore. Objekti mbetet një element i rëndësishëm në jetën institucionale të qytetit.

### 6. STACIONI I AUTOBUSËVE - PRIZREN

I ndërtuar gjatë periudhës socialiste, Stacioni i Autobusëve në Prizren është një nyje kryesore e transportit publik në qytet. Objekti ka një strukturë funksionale me një ndërtesë qendrore dykatëshe dhe një terminal të mbuluar për autobusët. Me një arkitekturë utilitare, ai përfshin elemente betoni dhe çatie metalike të valëzuar, duke reflektuar stilin racional të ndërtimit të kohës. Pas dorëzimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vitin 2023, stacioni është nën menaxhimin e Komunitetit të Prizrenit, duke vazhduar të luajë një rol kyç në lidhjen e qytetit me destinacione brenda dhe jashtë Kosovës.

### 7. HOTEL "PUTNIK"

I ndërtuar në vitin 1983 në Prizren, në "Rrugën Tirana", ky hotel kishte një sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> dhe ishte pjesë e zhvillimit urban të qytetit. Projekti u realizua nga zyra projektuese "PLAN", ndërsa arkitekti i instalacioneve ishte Miroslav Simeunovic. Hoteli ofronte shërbime akomoduese për vizitorët dhe turistët, por sot nuk ekziston më.

### 8. FAMIPA PRIZREN

Një ndërtesë industriale e ndërtuar në vitin 1983 si pjesë e fabrikës "Famipa", e specializuar në prodhimin e metaleve dhe plastikës. Objekti përfshinte hapësira të ndryshme prodhimi dhe administrate, të ndërtuara me beton të armuar dhe blloqe Siporex për izolim të mirë. Pas luftës, fabrika nuk u riaktivizua dhe sot disa pjesë të saj janë transformuar në hapësira tregtare.

### 9. FABRIKA E TEKSTILIT "PRINTEX"

E projektuar nga arkitektja Kalin-Vehovar Nives, kjo fabrikë u ndërtua në vitin 1974 në zonën e Bazhdarhanes. Me specializim në prodhimin e tekstilëve, Printex luajti një rol kyç në zhvillimin ekonomik të qytetit. Pas vështirësive ekonomike, fabrika u mbyll në vitet '90, por ndërtesa e saj mbetet një simbol i historisë industriale të Prizrenit.

### 10. HOTEL "VËLLAZËRIMI"

I ndërtuar në vitin 1970, ky hotel modernist u bë një nga simbolet e turizmit në Prizren. Me linja të pastra dhe fasadë të kombinuar me beton dhe xham, hoteli ofronte shërbime akomoduese dhe organizim ngjarjesh kulturore. Ai ka ruajtur tiparet e tij origjinale pavarësisht restaurimeve.

### 11. LAGJJA ORTAKOLL

E projektuar nga arkitektja Hysnije Hisari në vitin 1980, Lagjja Ortakoll ndodhet në veriperëndim të Prizrenit dhe është një nga zonat më të planifikuara të qytetit. Me ndërtesa pesë deri në tetë kate dhe hapësira publike funksionale si shkolla, parku dhe qendra shëndetësore, projekti kishte për synim krijimin e një hapësire të organizuar dhe të qëndrueshme për banim.

### 12. QENDRA SHËNDETËSORE

Projektuar nga arkitekti Bezbradica Stevan, Qendra Shëndetësore ndodhet në qendrën e Prizrenit dhe është një objekt strategjik i organizuar në tre blloqe: mjekësia e përgjithshme, radiologjia dhe sektori teknik. Me korridore të gjera dhe ndriçim optimal, ndërtesa mbetet një element kyç i infrastrukturës shëndetësore të qytetit.

### 13. FABRIKA E VESHMBATHJEVE "KOMUNA"

E ndërtuar në vitin 1986 nga arkitektja Peric Leposava, kjo fabrikë ishte një ndër objektet kryesore industriale të Prizrenit. Ajo pati ndikim të madh në ekonominë lokale, duke krijuar vende pune dhe duke përmbytur nevojat e tregut vendas për textile.

### 14. OBJEKTI I KEK-UT

I ndërtuar në vitet 1970-1980, ky objekt shërbente si qendër për menaxhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në Prizren. Me arkitekturë moderniste dhe një dizajn funksional, objekti ka ndikuar në zhvillimin urban të qytetit dhe vazhdon të mbetet pjesë e infrastrukturës energjetike.

### 15. RADIO "PRIZRENI"

Ndërtuar në vitin 1978 nga arkitekti Rasim Hoxha, ky objekt u ndërtua për të mbështetur transmetimet e Radio Prizrenit. Struktura përfshinte studio, zyra administrate dhe hapësira për shërbime të tjera. Objekti është ndërtuar me një sistem linear të ngritur mbi nivelin e terrenit për stabilitet më të lartë.

### 16. ENTI PËR INKUADRIM

Ndërtesë moderne e ndërtuar në vitin 1969 nga arkitekti Dobriboje Bojkovic, si pjesë e zhvillimit urban të Prizrenit. Me linja të pastra dhe funksionalitet të lartë, ky objekt reflekton arkitekturën postmoderniste të kohës. Ka shërbyer si institucion social dhe administrativ.

### 17. LAGJJA BAZHDARHANE

Lagjja Bazhdarhane, projektuar nga arkitekti Pavle Pavlovic në vitin 1978, është një projekt urbanistik i fundit të viteve '70, i cili kombinon hapësirat rezidenciale me ato rekreative dhe publike. E vendosur në Prizren, projekti përfshinte sistemimin e gjelbërimit, hapësira për komunitetin dhe terrene sportive, duke reflektuar një qasje të strukturuar ndaj planifikimit urban.

### 18. QENDRA EDUKATIVE DHE SOCIALE "YLLKA"

E ndërtuar në vitet 1970-1980, kjo qendër ofronte ambiente për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Arkitektura e saj përfshin hapësira të ulëta, të shtrira horizontalisht, me hapësira të gjelbra për lojëra. Qendra ishte një pikë e rëndësishme për komunitetin lokal.

### 19. HALLA E SPORTEVE

E projektuar nga arkitektët Miroslav Cocanovic dhe Dragan Radulovic, Halla e Sporteve është një nga objektet më të rëndësishme sportive të Prizrenit. Me një sipërfaqe prej 8,430.76 m<sup>2</sup>, ajo është e ndarë në tre grupe funksionale, duke siguruar ndarje të qartë të rrjedhave të lëvizjes për sportistët dhe publikun. Ky objekt shërben si qendër e aktiviteteve sportive dhe komunitare në qytet.

